



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR**

Nr. 1057 prot.

Shkodër, më 21.01. 2025

Lënda: Dërgim relacioni dhe projekt-vendimi

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

**Të nderuar këshilltarë,**

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin:

**Për miratimin në parim të vlerës së bashkëfinancimit dhe listës së përfituesve për realizimin e projektit “Përmirësim i Infrastrukturës, kryesisht në zonat informale” (Rikonstruksion Rruga Roza Lejn dhe Degëzime)**

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,



Relacion: 3 faqe  
Pr/Vendim: 2 faqe  
Shkresë MEKI: 1 faqe  
Nr. Kopje: 4 Kopje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM EKONOMIK  
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE STREHIMIT

Nr. 1054/prot.  
11

Shkodër, më 21.01. 2025

**RELACION**

**Për miratimin në parim të vlerës së bashkëfinancimit dhe listës së përfituesve për realizimin e projektit “Përmirësim i Infrastrukturës, kryesisht në zonat informale” (Rikonstruksion Rruga Roza Lejn dhe Degëzime)**

**Të nderuar këshilltarë,**

në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr. 9936, fatë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar; VKM nr. 405 datë 01.06.2016, Strategjia e strehimit Social 2016 – 2025; VKB nr. 76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025 – 2027 të Bashkisë Shkodër” si dhe shkresës nr. 15900 datë 18.12.224 të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025”, paraqitet pranë jush relacioni si më poshtë vijon:

Në zbatim të shkresës nr. 15900 datë 18.12.224 të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025”, për njoftim të hapjes së thirrjes për aplikime, Bashkia Shkodër duke marrë parasysh numrin e lartë të banorëve dhe mungesën e investimeve në rrugët e zonës “Mark Lula”, përkatësisht Rruga Roza Lejn dhe Degëzime në të cilat mungon tërësisht infrastruktura nëntokësore, asfaltike, ndriçimi apo sinjalistika synon që të aplikojë në këtë thirrje për projekte me projektin Për miratimin në parim të vlerës së bashkëfinancimit dhe listës së përfituesve për realizimin e projektit “Përmirësim i Infrastrukturës, kryesisht në zonat informale” (Rikonstruksion Rruga Roza Lejn dhe Degëzime)

Sipas kriterëve dhe termave të referencës së thirrjes për projekte, përkatësisht pika 2.3.3.d “Përmbajtja e dosjes së aplikimit dhe dosjes së plotë të projektit, për cdo kategori programi” për projekt propozimet në fushën e Përmirësimit të infrastrukturës kryesisht në zona informale që janë në proces legalizimi, si dhe në zona me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj., ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme, është e nevojshme miratimi në parim nga ana e Këshillit Bashkiak i vlerës së bashkëfinancimit dhe listës emërore të familjeve përfituese.

Përmes VKB nr. 76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025 – 2027 të Bashkisë Shkodër” është miratuar fisha buxhetore P.AD141.Q2.O1.A1 “Rikonstruksion rruga Roza Lejn në vlerën 20,415,000 lekë. Ky projekt konsiston në ndërhyrjen në këtë rrugë, të lagjes nr. 5 me problematika të shumta infrastrukture nëntoksore dhe asfaltike. Duke qënë se nevojat për ndërhyrje infrastrukture në këtë lagje janë të mëdha dhe duhet të maksimizojmë këto ndërhyrje në sa më shumë rrugë të qytetit dhe njësive administrative, në kuadër të thirrjes për projekt propozime nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit propozojmë që të aplikojmë pranë kësaj Ministrie me projektin Për miratimin në parim të vlerës së bashkëfinancimit dhe listës së përfituesve për realizimin e projektit “Përmirësim i Infrastrukturës, kryesisht në zonat informale” (Rikonstruksion Rruga Roza Lejn dhe Degëzime). Kështu do të shtohen në këtë investim të rrugës Roza Lejn edhe rrugë të tjera, degëzime të saj, duke e zmadhuar kështu sipërfaqen e ndërhyrjes dhe realizuar një projekt në një bllok të tërë rrugësh. Kjo do të bëjë që të kemi një përdorim më efektiv të fondeve të bashkisë dhe fondeve të buxhetit të shtetit.


Zona pjesë e projektit ka një numër të lartë banorësh dhe është jashtë kushteve optimale të shërbimeve publike. Realizimi i këtij projekti do të ishte në dobi të një numri më të lartë se 580 banorësh dhe duke qënë se një nga kriteret e thirrjes për aplikime është paraqitja e listës me mbi 50 kryefamiljarë që janë përfitues të këtij projekti, bashkia Shkodër ka evidentuar përmes shërbimeve sociale dhe punonjësve të lagjes nr. 5 listën bashkëngjitur. Sa më sipër kërkojmë nga ana e Juaj:

1. Miratimin në parim të bashkëfinancimit për projektet e investimeve që do të financohen nga buxheti i shtetit dhe Bashkia Shkodër për realizimin e projektit “Përmirësim i Infrastrukturës, kryesisht në zonat informale” (Rikonstruksion Rruga Roza Lejn dhe Degëzime) në vlerën totale 68,050,000 lekë, nga ku:

- Bashkia Shkodër angazhohet të bashkëfinancoj projektin në masën 30% në vlerën 20,415,000 lekë të preventivit total, burimi i financimit buxheti i bashkisë Shkodër viti 2025, fisha e projektit P.AD141.Q2.O1.A1.
- Buxheti i Shtetit bashkëfinancon projektin në masën 70% në vlerë 47,635,000 leke të preventivit total.

2. Miratimin e listës emërore të familjeve përfituese nga realizimi i këtij investimi.


Duke ju falenderuar për mbështetjen tuaj, Ju ftoj ta votoni propozimin për miratimin e projekt vendimit.




Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm  
Ekonomik

Bekim Nema 

Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Arliunde Krupa 

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të  
Territorit

Dulzim Doshi 



J. Soud

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
DREJTORIA E STREHIMIT

15900  
Nr. \_\_\_\_/ Prot.

18 12  
Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

Lënda: Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025.

28105  
26.12.2024

BASHKISË

SHKODËR

DREJTORIA E TITULLARIT:

Në zbatim të ligjit "Për buxhetin e vitit 2025" dhe ligjit 22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar, ju bëjmë me dije mbi hapjen e thirrjes për projekte të reja për programet e strehimit për vitin 2025; mbi Termat e Referencës, afatet, Dosjen/ Formularët e Aplikimit dhe kushtet për përfitimin e fondeve buxhetore.

Dosja e Aplikimit, dokumentacioni që do të shoqërojë formatin e aplikimit, kriteret skualifikuese, tabelat përkatëse, sistemi i pikëzimit dhe kufijtë e financimit/ bashkëfinancimit për çdo kategori projekti jepen në lidhjen nr.1 dhe lidhjen nr.2 (bashkëlidhur), miratuar me Urdhër Ministri.

Të gjitha tabelat përmbledhëse të listave emërore të dërgohen edhe në soft copy, në formatin excel, në adresën e email-it: \_\_\_\_\_;

Lidhjet nr.1 dhe nr.2 do të publikohen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në adresën: \_\_\_\_\_

Duke Ju falënderuar,



MINISTËR  
Blendi GONXHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR**

Nr. 1054 / prot.  
2

Shkodër, më 21 . 01 . 2025

**PROJEKT VENDIM**


Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025

**Për miratimin në parim të vlerës së bashkëfinancimit dhe listës së përfituesve për realizimin e projektit “Përmirësim i Infrastrukturës, kryesisht në zonat informale” (Rikonstruksion Rruga Roza Lejn dhe Degëzime)**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të dates \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025, me propozim të kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr. 9936, fatë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”. i ndryshuar; VKM nr. 405 datë 01.06.2016, Strategjia e strehimit Social 2016 – 2025; VKB nr. 76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025 – 2027 të Bashkisë Shkodër” si dhe shkresës nr. 15900 datë 18.12.224 të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2025” sipas relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër:

**VENDOSI:**

1. Miratimin në parim të bashkëfinancimit per projektet e investimeve qe do te financohen nga buxheti i shtetit dhe Bashkia Shkoder për realizimin e projektit “Përmirësim i Infrastrukturës, kryesisht në zonat informale” (Rikonstruksion Rruga Roza Lejn dhe Degëzime) në vlerën totale 68,050,000 lekë, nga ku:
  - Bashkia Shkodër angazhohet të bashkëfinancoj projektin në masën 30% në vlerën 20,415,000 lekë të preventivit total, burimi i financimit buxheti i bashkise Shkodër viti 2025, fisha e projektit P.AD141.Q2.O1.A1.
  - Buxheti i Shtetit bashkëfinancon projektin në masen 70% në vlere 47,635,000 leke të preventivit total.
2. Miratimin e listës emërore të familjeve përfituese nga realizimi i ketij investimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



Zv. Kryetar

Orind Beqiri

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik

Bekim Nema

Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Strehimit

Arllinda Kruja

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

Carle Hoxha

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Melvan Mushi

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Enis Veseli

Drejtoria Juridike

Eni Sejdiu